



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2663/2 prot.

Pogradec, më 16 . 06 2021

VENDIM

NR. 50 , DATË 14.06 .2021

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË
PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC TË NJË PJESE TË PASURISË
NR. 731/150, VOL 9, FQ.152 ZK 2648, ME SIPËRFAQE 761 M2 TRUALL
+ 386 M2 NDËRTESEË, NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE
ENERGJISE ME NDERMARRJE VARESIE "ALBMINIERA" SHA
PRONARE E KËSAJ PASURIE**

Në mbështetje të nenit 8, shkronjës "a" dhe shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave organeve të qeverisjes vendore", shkresës nr 3215 prot datë 06/04/2021 te Ministres se Infrastruktures dhe Energjise zonjes Belinda Balluku, si dhe pas relacionit të paraqitur nga Sektori monitorimit te kontratave, evidentimit dhe inventarizimit te aseteve si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec të sipërfaqes së truallit prej 761 m2, prej të cilave 386 m2 ndërtesë, pjesë e pasurisë Nr. 731/150, Vol 9, Fq. 152, ZK. 2648, nga Albminiera sh.a pronare e kesaj pasuri
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 (Dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotirag MANGËRI

